



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5382/11 Prot.

Tiranë, më 4.9.2025

URDHËR

NR. 430, DATË 4.9.2025

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NGA
MASTER PROFESIONAL NË “MËSIMDHËNIE PËR CLAB NË GJUHË ANGLEZE”,
NË MASTER I SHKENCAVE NË “MËSUESI NË GJUHË E HUAJ, GJUHË
ANGLEZE”, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë, nga “Master Profesional” në “Mësimdhënie për CLAB në Gjuhë Angleze”, në “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë e Huaj, Gjuhë Angleze”, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht me kodet 72MS0114S dhe 72MS0114A, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë e Huaj, Gjuhë Angleze”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, referuar nivelit 7, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë e Huaj, Gjuhë Angleze”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

~~ANA KAPAJ~~

